



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1126 Prot.

Tiranë, më 01.08.

2024

V E N D I M

Nr.215 , Datë 01 /08/ 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 19 Regj, datë 07.02.2024, paraqitur nga ankuesi A.M (në vijim ankuesi), kundër Bashkisë Vorë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës” dhe “ngjyrës”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, z. A.M , në mes të tjerash informon se: “Unë quhem A.A.M, i datëlindjes 31.05.1969. Jam aktualisht në Bashkinë e Vorës, ka 16 vjet që punoj në këtë bashki, me një vlerësim pune shumë të mirë. Në nëntor të vitit 2023, i kam dërguar shkresë zyrtare DAP, Kryetarit të Bashkisë Vorë, Këshillit Bashkiak, për statusin, sepse nuk ma kanë dhënë vetëm mua, sepse jam me ngjyrë dhe kjo gjë më ka diskriminuar për statusin civil (emërimin), ndërsa kolegët e tjerë e kanë marrë statusin. Kërkoj nga KMD, trajtimin e ankesës timë, në mënyrë që të trajtohem i barabartë me të tjerët.

Unë si punonjës, por edhe pjestar i shoqërisë civile, duke qenë gjithashtu edhe në terren, nuk jam pyetur asnjëherë për pakot e ndihmave që ofron Shërbimi Social dhe Bashkia Vorë. Unë bëj pjesë në familjen egjiptiane”

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Përfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e çështjes së tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtëpërdrejtë nga diskriminimi për shkak të “racës” dhe “ngjyrës”, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/a/b/c, ku përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”* ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në racë dhe ngjyrë, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.267/2 prot, datë 26.02.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Vorë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Në vijim të kësaj kërkesë, me shkresën nr.1109/1 prot., datë 08.03.2024, ka kthyer përgjigje Bashkia Vorë, duke parashtruar si vijon:

z. A.M ka filluar marrëdhënien e punësimit në Bashkinë Vorë me anë të kontratës nr.148 prot, datë 04.07.2016, si “*specialist*”, pranë Sektorit të Ujësjiellësit. Me vendimin nr.47/1, datë 01.02.2017, është liruar me motivacionin “*kalim në detyrë tjetër*”. Më tej, me anë të kontratës nr.60/5 prot, datë 01.02.2017, ka kaluar punonjës me kontratë, “*specialist fushe*”, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Vorë. Me urdhrin nr.126 datë 23.09.2020 është liruar nga detyra, shkurtim i vendit të punës për shkak të ristrukturimit. Më pas me urdhrin nr.69, datë 06.10.2020, është emëruar përsëri në pozicionin “*specialist*”, në Brigadën e Shërbimit të Mirëmbajtjes, pranë Drejtorisë së Punëve dhe Shërbimeve.

Me urdhrin nr.122 datë 09.02.2021 “*Për kalim në detyrë tjetër*” për shkak të ristrukturimit nga pozicioni “*specialist*”, në Brigadën e Shërbim Mirëmbajtjes, pranë Drejtorisë së Punëve dhe Shërbimeve, ka kaluar në pozicionin “*specialist*” në Brigadën e Shërbim Mirëmbajtjes pranë Drejtorisë së Mirëmbajtjes dhe Mbikëqyrjes së Infrastrukturës.

Me urdhrin nr.277, datë 02.03.2021 “*Për kalim në detyrë tjetër*” ka kaluar nga *specialist brigade* në *punonjës me kontratë specialist fushe*, në Sektorin e Politikave Sociale dhe Barazisë Gjinore pranë Drejtorisë së Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Më tej me kontratën nr.90, datë 02.03.2021 vijon punësimin në këtë pozicion.

Referuar pretendimeve të z.M. , ato nuk qëndrojnë, pasi janë subjektive dhe të pa mbështetura në ligj dhe në prova. Pas kërkesave të shumta që z.M. ka dërguar pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për ndryshim pozicioni, ato janë bërë të mundura, sipas urdhrave bashkëlidhur.

Me anë të shkresës me nr.5316 prot, datë 03.10.2023, nëpërmjet të cilës z.M. ka kërkuar të marrë statusin e nëpunësit civil, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e ka informuar me shkresën nr.473 prot datë 25.01.2024, se vendet e lira me shërbimin civil në Bashkinë Vorë, shpallen duke u bërë publike sipas përcaktimeve ligjore.

Z. M. nuk ka bërë asnjë kërkesë, bashkë me dokumentacionin përkatës, për të aplikuar në ndonjë nga pozicionet e shpallura. Gjithashtu, i është bërë me dije vazhdimisht të informohet në stendat e informimit pranë Bashkisë Vorë, nëpërmjet faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe në faqen zyrtare të bashkisë për vendet e shpallura për pranim në shërbimin civil në mënyrë që të marrë pjesë në konkurim. Përmbajtja e ankesës z.M. tregon qëndrim të njëanshëm, subjektiv, të pakënaqur, duke shprehur haptazi pakënaqësinë.

Për sa më sipër, pretendimet e z.A.M nuk qëndrojnë, përkundrazi ai është respektuar dhe trajtuar duke gëzuar liritë dhe të drejtat njësoj si të tjerët. Për të përfituar statusin e nëpunësit civil, duhet të bëhet aplikim për pozicionet e shpallura në bazë të kriterëve të veçanta.

2. Nëpërmjet shkresës nr.267/4 prot, datë 26.03.2024, ankuesit i janë komunikuar përgjigja dhe aktet e depozituara nga ana e Bashkisë Vorë. Ankuesi ka depozituar kundërshtimet e tij, me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr.267/5 prot, datë 19.04.2024.
3. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”³, të ndryshuar dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr.267/6 prot, datë 01.05.2024, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 09.05.2024. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 09.05.2024, me pjesmarrjen e të dy palëve, ankuesit i cili ishte personalisht prezent dhe Bashkisë Vorë, përfaqësuar nga znj. D.Gj, juriste pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik, sipas autorizimit nr.2564 prot., datë 08.05.2024, lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Vorë.

Gjatë seancës dëgjimore, palët mbajtën të njëjtin qëndrim që kishin përcjellë pranë Komisionerit nëpërmjet komunikimit shkresor.

4. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 2714 prot., datë 16.05.2024, Bashkia Vorë depozitoi informacion dhe akte shtesë në lidhje me ankesën.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi A.M është në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Vorë, në pozicionin “Punonjës Specialist Fushe”, në Drejtorinë e Politikave Sociale.

Referuar vendimit nr.3599 regj, datë 30.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se ankuesi është kryetar i shoqatës “Drita”, një organizatë jofitimprurëse e cila ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të komunitetit egjiptian.

Në bazë të akteve të administruara rezulton se, marrëdhënia e punësimit midis ankuesit dhe Bashkisë Vorë ka filluar në datën 04.07.2016. Me anë të kontratës nr.148 prot, datë 04.07.2016, të lidhur midis palëve, ankuesi ka filluar punë si “specialist”, pranë Sektorit të Ujësjiellësit. Në vijim të marrëdhënies së punësimit me Bashkinë Vorë, ankuesi ka mbajtur pozicionet e punës si vijon:

Me vendimin nr.47/1, datë 01.02.2017, ankuesi është liruar nga detyra si “specialist” pranë Sektorit të Ujësjiellësit me motivacionin “kalim në detyrë tjetër” dhe në vijim me anë të kontratës nr.60/5

³ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar: “*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.*”

prot datë 01.02.2017, është emëruar punonjës me kontratë në pozicionin “specialist fushe”, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Vorë.

Me urdhrin nr.126, datë 23.09.2020 “Për lirim nga detyra”, ankuesi është liruar nga detyra për pozicionin “Punonjës me kontratë-Specialist Fushe” pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Politikave Sociale me motivacionin “Shkurtim i vendit të punës si pasojë e ristrukturimit të Bashkisë Vorë”. Më pas me urdhrin nr.69, datë 06.10.2020 “Për emërim në detyrë”, ankuesi është emëruar në detyrën “Specialist në Brigadën e Shërbimit të Mirëmbajtjes”, pranë Drejtorisë së Punëve dhe Shërbimeve në Bashkinë Vorë. Marrëdhëniet e punës për pozicion e sipërcituar janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës me nr.7278 prot, datë 06.10.2020, nënshkruar midis ankuesit dhe Bashkisë Vorë.

Me urdhrin nr.122, datë 09.02.2021 “Për kalim në detyrë tjetër”, në kuadër të ristrukturimit, ankuesi është emëruar në detyrën “Specialist në Brigadën e Shërbim Mirëmbajtjes” pranë Drejtorisë së Mirëmbajtjes dhe Mbikqyrjes së Infrastrukturës, në Bashkinë Vorë.

Me urdhrin nr.277, datë 02.03.2021 “Për kalim në detyrë tjetër”, ankuesi ka kaluar nga detyra “Specialist në Brigadën e Shërbim Mirëmbajtjes” pranë Drejtorisë së Mirëmbajtjes dhe Mbikqyrjes së Infrastrukturës, në detyrën “Punonjës Specialist Fushe” në Sektorin e Politikave Sociale dhe Barazisë Gjinore, pranë Drejtorisë së Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Ndihmës Ekonomike dhe Strehimit, në Bashkinë Vorë. Marrëdhëniet e punës për pozicion e sipërcituar janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës me nr.1731 prot, datë 02.03.2021, nënshkruar midis ankuesit dhe Bashkisë Vorë.

Ankuesi i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë Vorë me kërkesën nr.5316, datë 03.10.2023 nëpërmjet të cilës kërkon ndjekjen e procedurave nga ana e Bashkisë Vorë, për marrjen e statusit të nëpunësit civil, për shkak se pozicioni i mbajtur prej tij, sipas ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil, përmban marrjen e këtij statusi. Në lidhje me këtë kërkesë, Bashkia Vorë i ka kthyer përgjigje ankuesit me shkresën nr.473 prot, datë 25.01.2024. Në këtë shkresë ndër të tjera, Bashkia Vorë informon ankuesin se, referuar vendeve vakante në Bashkinë Vorë, të cilat janë shpallur dhe janë bërë publike sipas përcaktimeve ligjore, nuk rezulton të ketë aplikuar për të marrë pjesë në konkurim. Bazuar në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Bashkia Vorë, informon ankuesin se, procesi i përzgjedhjes bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet konkurimit, duke e orientuar ankuesin që të informohet në lidhje me vendet e shpallura në shërbimin civil, nëpërmjet faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në stendat e informimit dhe faqen zyrtare të Bashkisë Vorë.

Kërkesën për të qenë pjesë e shërbimit civil, ankuesi i’a ka drejtuar edhe Departamentit të Administratës Publike (DAP). Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr.5643/1 prot., datë 15.11.2023, DAP ka informuar ndër të tjera ankuesin se, DAP nuk është përgjegjëse për marrjen e statusit të nëpunësit civil në pozicionin pranë Bashkisë Vorë, por ankuesi duhet t’i drejtohet njësisë përgjegjëse pranë njësisë së qeverisjes vendore, dhe se, për të marrë pjesë në procedurat e

konkurimit të cilat organizohen nga DAP, aplikimi duhet të kryhet elektronikisht përmes portalit të rekrutimit *on-line*, ndërsa shpalljet e vendeve të lira bëhen publike në faqen zyrtare të DAP.

Me urdhrin nr.120, datë 30.11.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vorë “Mbi miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe Njësi Administrative Prezë dhe Bërxull për vitin 2024”, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Vorë për vitin 2024.

Me qëllim zbatimin e strukturës së re të institucionit, me urdhrin nr.01, datë 03.01.2024 “*Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit në Bashkinë Vorë*” është ngritur Komisioni i Ristrukturimit. Me shkresën nr.452 prot datë 08.01.2024 “*Njoftim për fillimin e procedurës së ristrukturimit të Bashkisë Vorë*”, Komisioni i Ristrukturimit ka njoftuar punonjësit mbështetës Specialist Fushe, ku përfshihet edhe ankuesi. Njëpëmjet kësaj shkrese, punonjësit janë njoftuar se në bazë të strukturës së re të miratuar kanë ndodhur riorganizime, shtim/shkurtim të vendeve të punës dhe se Komisioni i Ristrukturimit do të shqyrtojë mundësinë e transferimit në pozicionet e krijuara në strukturën e re.

Referuar strukturës së Bashkisë Vorë, miratuar me urdhrin nr.120, datë 30.11.2023, të Kryetarit të Bashkisë, si dhe parashtrimeve të palëve, rezulton se, në përfundim të procesit të ristrukturimit ankuesi ka vijuar punën në pozicionin “Specialist Fushe”, në Drejtorinë e Politikave Sociale. Nuk rezulton që të jetë nxjerrë një akt për sistemimin e ankuesit në pozicionin “Specialist fushe”, tashmë në Drejtorinë e Politikave Sociale.

Ankuesi i është drejtuar Komisionerit me ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të racës dhe ngjyrës, për shkak të mosdhënies së statusit të nëpunësit civil nga ana e Bashkisë Vorë.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i këtij ligji si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim.
- në krahasim me sesi janë trajtuar, trajtohen ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose disa nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje ligjore nga diskriminimi.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim dhe më konkretisht në lidhje me pretendimin e tij për marrjen e statusit të nëpunësit civil. Nëse konstatohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, atëherë do të vijohet me analizën, nëse ky trajtim të cilit i është nënshtruar ankuesi ka ardhur apo jo si rezultat i shkaqeve të pretenduara, të cilat duhet gjithashtu të gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Nga tërësia e provave të administruara, rezulton e provuar se, pozicioni aktual “Punonjës Specialist Fushe”, në Drejtorinë e Politikave Sociale dhe njëkohësisht pozicionet e punës në të cilat ankuesi ka punuar përgjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së tij të punësimit me Bashkinë Vorë, që prej momentit fillestar të vendosjes së këtyre marrëdhënieve në datën 04.07.2016, kanë qenë pozicione të cilat përfshihen në fushën e veprimit të Kodit të Punës. Asnjë prej tyre nuk rezulton që të jetë përfshirë ose të përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr.152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”, të ndryshuar.

Ligji nr.152/2013, i ndryshuar, rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil (në vazhdim “marrëdhënia e shërbimit civil”) dhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil. Sipas nenit 20, të këtij ligji sanksionohet: *“1. Pranimi në shërbimin civil bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. 2. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi kombëtar, që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit.”*

Sa më sipër, për t’u bërë pjesë e shërbimit civil, duhet që personi të aplikojë dhe të bëhet pjesë e procedura të konkurimit të shpallura nga institucionet përgjegjëse. Referuar ligjit nr.152/2013, të ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë vetë përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil.

Në çështjet objekt shqyrtimi, nuk rezulton që ankuesi të ketë aplikuar dhe të jetë bërë pjesë e procedurave të konkurimit për pozicione pune në fushën e shërbimit civil të shpallura nga ana e Bashkisë Vorë.

Sipas ankuesit, Bashkia Vorë nuk i bën publike procedurat e konkurimit për vendet e lira të punës pjesë e shërbimit civil dhe kjo është arsyeja që ankuesi nuk ka konkuruar.

Në referim të pikës 1, të nenit 8 “*Plani vjetor i pranimi në shërbimin civil*”, përcaktohet se: “1. *Administrimi i shërbimit civil bazohet në planin vjetor të pranimi.*”, ndërsa më tej, pika 2 e këtij neni përcakton : “2.*Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore. Planet vjetore të miratuara sipas kësaj pike publikohen.*”

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar kanë dalë një sërë aktesh nënligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme procedurën e konkurimit, dhe konkretisht vendimi nr. 243, datë 18.03.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar dhe vendimi nr. 242, datë 18.03.2015 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar. Në të dy këto akte, respektimisht pikat 6 dhe 7, të Kreut II, përcaktohet se, njësitë e qeverisjes vendore bëjnë shpalljen e procedurës së pranimi në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendat e informimit të publikut, si dhe në faqen e tyre të internetit në rast se kanë, dhe se, përveç këtyre mënyrave detyruese të shpalljeve, mund të përdoren si mënyra alternative të shpalljes së procedurës së pranimi çdo mjet tjetër të konsideruar të përshtatshëm për shpalljen, të njohur nga legjislacioni në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Vorë e prapësoi si të pabazuar pretendimin e ankuesit se bashkia nuk bën publike procedurat e rekrutimit për pozicionet e parashikuara në ligjin për nëpunësin civil. Në mbështetje të pretendimit të saj, Bashkia Vorë depozitoi shkresën nr.550 prot datë 26.01.2024 “*Plani vjetor 2024*”, nëpërmjet të cilës është miratuar numri i pozicioneve që do të shpallen për rekrutim në Bashkinë Vorë, i ndarë sipas kategorive përkatëse, numrit respektiv për secilën kategori dhe periudhën përkatëse kur parashikohet zhvillimi i procedurës së rekrutimit. Referuar planit vjetor 2024, konstatohet se në total numri i vendeve në shërbimin civil që do të shpallen për rekrutim nga Bashkia Vorë është 22 (njëzetë e dy), nga të cilët, 1 (një) pozicion në kategorinë e lartë drejtuese, 5 (pesë) pozicione në kategorinë e ulët drejtuese dhe 16 (gjashhtëmbëdhjetë) pozicione në kategorinë ekzekutive. Nëpërmjet shkresës nr.718 prot, datë 06.02.2024, Bashkia Vorë ka dërguar për publikim në Agjencinë Komnëtare të Punësimit dhe Aftësive, Planin vjetor për vitin 2024.

Nga aktet e vendosura në dispozicion nga Bashkia Vorë, konstatohet se, aktualisht për vitin 2024, janë realizuar shpalljet për dy vende vakante të punës, që bëjnë pjesë në shërbimin civil, konkretisht Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Përgjegjës në Sektorin e Auditit të Brendshëm Financiar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se shpalljet e procedurave për 2 (dy) vendet vakante pjesë e shërbimit civil, janë përcjellë për publikim pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Integritit të Politikave të BE-së, pranë Bashkisë Vorë dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Ankuesi pretendoi se, edhe pse ka 16 vite punë pranë Bashkisë Vorë, vetëm atij nuk i është dhënë statusi si nëpunës civil, ndërsa kolegët e tjerë e kanë marrë statusin.

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, Komisioneri rithekson se, e vetmja mënyrë për t'u bërë pjesë e shërbimit civil dhe për të fituar statusin e nëpunësit civil, është nëpërmjet marrjes pjesë në procedurat e konkurimit të shpallura për pozicionet e punës që bëjnë pjesë në shërbimin civil. Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, nuk është një kriter që i mundëson ankuesit, fitimin e statusit të nëpunësit civil. Ndërkohë, ankuesi nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me kolegët e tjerë që sipas ankuesit e kanë marrë statusin, në mënyrë që Komisioneri të vlerësonte nëse këta punonjës kanë qenë në të njëjtat kushte me ankuesi, por ndryshe nga ai kanë fituar statusin e nëpunësit civil.

Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Vorë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Rekomandohet ankuesi që të ndjekë shpalljet e vendeve të lira të publikuara në në portalin *“Shërbimi Kombëtar i Punësimit”*, të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në stendat e informimit të publikut dhe në faqen e internetit të Bashkisë Vorë, si dhe në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, me qëllim aplikimin dhe pjesëmarrjen në procedurat e konkurimit për vendet e lira pjesë e shërbimit civil, si e vetmja mënyrë që ankuesi të bëhet pjesë e këtij shërbimi dhe të fitojë statusin e nëpunësit civil, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi që rregullojnë këtë process.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit A.M , në të drejtën për punësim, për shkak të *racës dhe ngjyrës*, nga ana e Bashkisë Vorë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Raca, ngjyra
Fusha: Punësim

Lloji i vendimit: Mosdiskriminim